REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALKET Z. MANÇKA
ADRESA NR.2, ASIM ZENELI, NR.10, NR.6
TEL: 693645101

# PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE

(AKT THEMELIMI DHE STATUT)

**Nr. repertori: 5675** **Nr. koleksioni: 2789**

**Tirane më 09/08/2023**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A20230514002796528 89

*Akti noterial përbëhet nga 8 fletë

A2023051400279652889

**AKT THEMELIMI**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"Home Tech" Sh.p.k.**

Sot, më datë _09_/08/2023 , para meje Noter ALKET Z. MANÇKA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.2, ASIM ZENELI, NR.10, NR.6, u paraqit personalisht:

- **ARC shpk**, shoqeri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT K81728025F regjistruar pranë Qenrës Kombëtare të Biznesit në datë 28.05.2008, me adresë Rruga "Themistokli Germenji", Nd. 1 dhe me administrator **Z. Zenel Hysenbegasi**, shtetas shqipëtar, lindur më 31.12.1979, në Pogradec dhe banues në Rruga 3 Deshmoret Kompleksi Line Konstruksion,H1 Ap4/1 Tiranë, mbajtës I kartës së identitetit Nr.034895788 Dhe Nr. Personal H91231047K, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar; dhe

- **Z. Redi Baduni**, shtetas shqipëtar, lindur më 15.11.1975, ne Tirane, banues ne Bulevardi Zogu I Pare Tiranë, Shqiperi, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. 032504166 dhe Nr. Personal H51115111O, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

të cilët kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë **"Shoqëria"**), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi, ligji nr. 9901, datë 14 prill 2008 "*Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare*", i ndryshuar dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, bashkëngjitur (më poshtë "Shtojca 1").

**Neni 1 - Emërtimi**

1.1 Emërtimi i Shoqërisë është "Home Tech" Sh.p.k.

**Neni 2 - Selia**

A2023051400279652889

2.1 Selia e Shoqërisë është Autostrada Tiranë-Durrës, KM 2, rruga dytesore Mëzez-Kashar Tirane Tirane TIRANE Pasuria Nr. 3/932-13, Zone Kadastrale 8160, Vol.25, Faqe 108, Shqipëri.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

**Neni 4 – Objekti i shoqërisë**

4.1 Ushtrimi i aktivitetit te import-eksportit te produkteve jo-ushqimore te cfaredo lloji, ne vecanti te pajisjeve elektrike, elektronike, elektro-shtepiake. Tregtimin e ketyre produkteve me shumice dhe/ose pakice edhe nepermjet platformave online.Qera ambjenti.

**Neni 5 – Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 100,000 Lekë.

5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 2 kuota, i gjithi i nënshkruar dhe i paguar, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të Shoqërisë, përcaktuar në nenin 7 të Statutit.

**Neni 6 - Kontributet**

4.1 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- Ortaku themelues: ARC shpk, zotëruese e një (1) kuote me vlerë të barabartë me 51,000(peseqindedhjet) Lekë që përbën 51% (pesëdhjet e njëpërqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;

- Ortaku themelues: Redi Baduni zotëruese e një (1) kuote me vlerë të barabartë me 49,000 Lekë që përbën 49% (dyzet e nënt përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;

## Neni 7 – Transferimi i kuotave

7.1 Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të vetë Statutit.

## Neni 8 – Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë, me afat 5 vjecar:

**Z. Klajdi Mersuli,** shtetas shqipëtar, lindur më Tiranë, në 02.11.1989 dhe banues në Rruga e Elbasanit, P4,Shk1, Ap17, Tiranë, mbajtës I kartës së identitetit Nr.036869884Dhe Nr. Personal I91102042H, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

- Specimeni i nënshkrimit_____

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "*Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare*", i ndryshuar dhe nenit 14 të Statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryrjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

## Neni 9 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

A20230514002796528889

9.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e këtij akti themelimi dhe të statutit të shoqërisë, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

9.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 10 – Gjuha**

10.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe. Bashkëlidhur Statuti i Shoqërisë.

**ORTAK**

ARC shpk

NIPT K81728025F
ARC sh.p.k
TIRANE - ALBANIA

Redi Baduni

**NOTER**

**Alket Z. Mançka**